



MUAJI GUSHT

1. † E DIEL. VI MATTHEUT (Shërimi i të paralizuarit).

Dalja dhe Falja e Kryqit të Nderuar. 7 djemtë Makabenj, Solomona, nëna e tyre, dhe Eleazari, mësuesi i tyre. Oshënare dëshmore Elesa.

Tingulli Tërthor I. Ungjilli mëngjesor ngjallësor VI.

Fillon Kreshma e Fjetjes së Hyjlindëses.

Bëhet Efqeli.

Në Mbrëmësore:

Shërbesa kryhet si zakonisht.

Pas “O ZOT, THIRRA...” psalen 7 Vargëzimet ngjallësore, që bëhen 8. “Lavdi...” dhe “Tani...”, Hyjlindësorja dogmatike e Ting. Tërth. I: “Në Detin e Kuq...”.

HYRJA, “O Jisu Krisht, dritë gazmore...” dhe PARAVARGU i ditës.

PASVARGJET ngjallësore. “Lavdi...” dhe “Tani...”, Hyjlindësorja e Pasvargjeve: “Tempull dhe derë je...”.

PËRLËSHORJA ngjallësore: “Fjalën e panisëshme...”.

“Lavdi...”, “Tani...”, Hyjlindësorja: “Gëzohu, derë e Zotit...”.

Në Mëngjesore:

Shërbesa kryhet si zakonisht.

Pas “PËRËNDI ËSHTË ZOTI...”, psalet Përlëshorja ngjallësore: “Fjalën e panisëshme...”. “Lavdi...”, po ajo:

“Fjalën e panisëshme...”. “Tani...”, Hyjlindësorja: “Gëzohu, derë e Zotit...”.

NDENJËSORET ngjallësore, sipas radhës.

BEKIMTORET ngjallësore, SHKALLESAT, DËGJIMI DHE PARAVARGU i tingullit.

SHKURTORJA, SHTEPIA e tingullit. SINAKSARI i ditës.

ZBRITËSORET: “I shenjti Izrael shkoi Detin e kuq...”.

“Le t’i lutemi Zotit...”, “Çdo frymë...” dhe UNGJILLI mëngjesor ngjallësor VI.

Pas Ungjillit lexohet: “Ne që pamë Ngjalljen...” dhe psalet PSALMI 50. Pas Psalmi 50 thuhet: “Lavdi...”, “Me ndërmjetimet e Apostujve...” etj. Më pas thuhet: “O Perëndi, shpëtoje popullin tënd...”.

MADHËSHTIMET: pas thirrjes: “Hyjlindësen dhe Mëmën e Dritës...”, psalet: “Më të nderuarën...” dhe Zbritësorja IX.

“I shenjtë është Zoti...” – “Lartësoni Zotin...”.

DËRGIMSORJA ngjallësore VI dhe Hyjlindësorja e saj.

LAVDËRIMET: psalen 8 Vargëzimet ngjallësore.

“Lavdi...”, Lavdia mëngjesore ngjallësore VI. “Tani...”, “E përmbibekuar je...”.

DHOKSOLOGJIA e Madhe, “Sot erdhi shpëtimi...”.

Në Liturgji:

ANDIFONET e së dielës.

Pas HYRJES psalet Përlëshorja ngjallësore: “Fjalën e panisëshme...” dhe e shenjtiti të kishës. Shkurtorja e Metamorfozës: “Përmbi malin...” (6 gusht).

APOSTULLI i së dielës së javës së 6-të të Letrave (Rom. 12:6-14).

UNGJILLI i së dielës së javës së 6-të të Mattheut (Mth. 9:1-8).

Te “VEÇAN TË TËRËSHENJTËN...”, psalet: “Të meriton...”.
 KUNGATORJA e së dielës: “Lavdëroni Zotin...”.
 “PAMË DRITËN...” dhe pjesa e mbetur e Liturgjisë.

Shënim: Nga mbrëmja e sotme deri mbrëmjen e 13 gushtit, në mbrëmje, përveç të shtunave dhe vigjiljes të së kremtes së Metamorfozës (6 gusht), kryhet Shërbesa e Paraklisit të Vogël dhe e Paraklisit të Madh drejtuar Hyj lindëses së Tërëshenjtë, të cilat ndërthuren me Shërbesën e Mbrëmësore.

Ditën e parë kryhet Paraklisi i Vogël, ndërsa ditën e dytë Paraklisi i Madh, e kështu me radhë, por nga e diela e parë e gushtit, që këtë vit bie në datën 1, dhe në vazhdim, siç është bërë zakon, Paraklisi i Madh kryhet mbrëmjen e së dielës, të së martës dhe të së enjtes, ndërsa Paraklisi i Vogël kryhet mbrëmjen e së hënës, të së mërkurës dhe të së premtes. Si rrjedhim, Paraklisi i Madh do të kryhet në datat 1, 3, 8, 10 dhe 12 gusht, ndërsa Paraklisi i Vogël do të kryhet në datat 2, 4, 6, 9, 11 dhe 13 gusht.

Të dielën në **mbrëmje** kryhet Shërbesa MBRËMËSORES së përditshme dhe e PARAKLISIT TË MADH ose vetëm Shërbesa e PARAKLISIT TË MADH.

NDËRTHURJA E MBRËMËSORES ME PARAKLISIN:

Në fillim kryhet shërbesa e Mbrëmësore së përditshme, sipas Tipikosë së Mbrëmësore, deri te “Tani përlëshoje shërbëtorin tënd...”. Pas “Tani përlëshoje...”, pa thënë Trishenjtin, fillon menjëherë shërbesa e Paraklisit duke lexuar Psalmin 142: “O Zot, dëgjo lutjen time...” dhe vazhdon shërbesa e Paraklisit sipas radhës.

Pas Shkurtores: “Mbroytje e paturpëruar...”, thuhet menjëherë paravargu: “Do ta kujtoj emrin tënd...” (Shkallesat: “Që prej rinisë sime...”, nuk thuhet). Pas paravargut thuhet Ungjilli i Paraklisit dhe vazhdon shërbesa e Paraklisit si zakonisht. Pas Trishenjtit, psalen Përlëshoret e ditës. Pas Përlëshoreve thuhet Lutja e Gjerë, e cila fillon nga kërkesa: “Mëshirona, o Perëndi, sipas mëshirë sate...” dhe në fund bëhet Përlëshimi i Madh, por para se të thuhet: “Me uratat...”, psalen Dërgimsoret e Fjetjes së Hyjlindëses: “O Apostuj, që u mblodhët...” të Paraklisit.

Kjo ndërthurje e Mbrëmësore me Paraklisin vlen si për Paraklisin e Vogël, ashtu edhe për Paraklisin e Madh.

Meqenëse sivjet data 1 gusht bie të dielën, atëherë të dielën **në mbrëmje** kryhet **Misteri i Efqelisë**.

- 2. † E hënë.** Transferimi i lipsanit të dëshmorit të parë dhe kryedhjakonit Stefan. Dëshmor i ri Theodhori.

Të hënë në **mëngjes**, kryhet shërbesa e MËNGJESORES së përditshme.

Liturgjia Hyjnore

APOSTULLI i shenjtorit (kërkoje të hënë e javës së 3-të të Veprave – Vep. 6:8-7:5, 47-60).

UNGJILLI i së hënës së javës së 7-të të Mattheut (Mtth. 13:54-58).

Të hënë në **mbrëmje**, kryhen shërbesat e MBRËMËSORES së përditshme dhe PARAKLISIT të VOGËL ose vetëm PARAKLISI I VOGËL (shih ndërthurjen e hollësishme në Tipikonë e datës 1 gusht, në mbrëmje).

3. E martë. Oshënare Saloma, miroprurëse. Oshënarët Dalmati, Fausti dhe Isaaku. Oshënare Theodhora në Selanik dhe e bija, Theopisti.

Të martën në **mëngjes**, kryhet shërbesa e MËNGJESORES së përditshme.

APOSTULLI i së martës së javës së 7-të të Letrave (1 Kor. 6:20-7:12).

UNGJILLI i së martës së javës së 7-të të Mattheut (Mtth. 14:1-13).

Të martën në **mbrëmje**, kryhen Shërbesat e MBRËMËSORES së përditshme dhe e PARAKLISIT TË MADH ose vetëm Shërbesa e PARAKLISIT TË MADH (shih ndërthurjen e hollësishme në Tipikonë e datës 2 gusht, në mbrëmje).

4. E mërkurë. 7 Djemtë e Efesit. Transferimi i lipsanit të oshënares Evdhokia. 9.000 dëshmorët në Persi.

Të mërkurën në **mëngjes**, kryhet Shërbesa e MËNGJESORES së përditshme.

APOSTULLI i së mërkurës së javës së 7-të të Letrave (1 Kor. 7:12-24).

UNGJILLI i së mërkurës së javës së 7-të të Letrave (Mtth. 14:35-15:11).

Të mërkurën në **mbrëmje**, kryhen Shërbesat e MBRËMËSORES së përditshme dhe e PARAKLISIT TË VOGËL ose vetëm Shërbesa e PARAKLISIT TË VOGËL (shih ndërthurjen e hollësishme në Tipikonë e datës 2 gusht, në mbrëmje).

5. E enjte. *Parakremtja e Metamorfozës.* Dëshmor Efsigni. Hierodëshmor Fabiani i Romës. Shën Nona. Dëshmor Emidi. Dëshmor Solevi.

Të enjten në **mëngjes**, kryhet Shërbesa e MËNGJESORES së përditshme.

APOSTULLI parakremtues (kërkoje javën e 32-të të Letrave - 1 Pjet. 1:1-2:10).

UNGJILLI i së enjtes së javës së 7-të të Mattheut (Mtth. 15:12-21).

Të enjten në **mbrëmje**, **nuk kryhet** Shërbesa e PARAKLISIT, por Mbrëmësorja kremtuese e së kremtes së Metamorfozës (Shndërrimit) së Zotit tonë Jisu Krisht:

Në Mbrëmësore:

Shërbesa kryhet si zakonisht.

Pas “O ZOT, THIRRA...” psalen 4 Vargëzimet e vetëmelodishme të së kremtes, të cilat bëhen 6 (dy të parat thuhën nga dy herë). “Lavdi...” dhe “Tani...”, e së kremtes.

HYRJA me temjanicë, “O Jisu Krisht, dritë gazmore...”, paravargu i ditës dhe leximet biblike (**Leximi I:** Eks. 24:12-18; **Leximi II:** Eks. 33:11-23; 34:4-6, 8; **Leximi III:** 3 Mbret. 19:3-9, 11-13, 15-16).

PASVARGJET e vetëmelodishme të së kremtes, bashkë me vargjet e tyre:

Vargu I: “*Të tutë janë qiejt, e jotja është edhe toka*”.

Vargu II: “*Thavori dhe Hermoni do të ngazëlleen në emrin tënd*”.

Lavdi...” dhe “Tani...”, e së kremtes.

PËRLËSHORJA e së kremtes (3 herë).

PËRLËSHIMI: “Ai që u shndërrua me lavdi në Malin Thavor përpara nxënësve dhe apostujve të tij të shenjtë, Krishti, Perëndia ynë i vërtetë...” (nga sot deri në shërbesën e Orës IX të datës 13 gusht, ky Përlëshim thuhet në të gjitha shërbesat e përditshme të natë-ditës).

6. † E PREMTE. METAMORFOZA (SHNDËRRIMI) E SHPËTIMTARIT TONË JISU KRISHT (SOTIRIT).

Hahet vaj, verë dhe peshk.

Në Mëngjesore:

Shërbesa kryhet si zakonisht.

Pas “PERËNDI ËSHTË ZOTI...”, psalet Përlëshorja e së kremtes (3 herë).

NDENJËSORET e së kremtes. SHKALLESAT: “Që prej rinisë sime...” dhe PARAVARGU i së kremtes.

“Le t’i lutemi Zotit...”, “Çdo frymë...” dhe UNGJILLI mëngjesor i së kremtes (Llk. 9:28-36).

Pas Ungjillit lexohet PSALMI 50. Dhe më pas thuhet: “Lavdi...”, “Me ndërmjetimet e Apostujve...”. “Tani...”, “Me ndërmjetimet e Hyjlindëses...”. “Përdëllyes, përdëllemë...”, tropari i vetëmelodishëm i së kremtes. Më pas thuhet: “O Perëndi, shpëtoje popullin tënd...”.

SHKURTORJA dhe SHTËPIA e së kremtes. SINAKSARI i ditës.

ZBRITËSORET: “Një kryq vijosi me shkop...”.

MADHËSHTIMET: Pas Këngës VIII thuhet: “Hyjlindësen dhe Mëmën e Dritës...” dhe, në vend të: “Më të nderuarën...”, psalet Kënga IX e të dy kanoneve dhe në fund thuhet dy irmoset e Këngës IX: “O Hyjlindëse,

Parajsë mistike...” dhe: “Mallkim’ i vjetër i stërgjyshit...”.

DËRGIMSORJA e së kremtes (3 herë).

LAVDËRIMET: psalen 3 Vargëzimet e përshembullta të së kremtes, të cilat bëhen 4 (e para thuhet dy herë).

“Lavdi...” dhe “Tani...”, e së kremtes.

DHOKSOLOGJIA e Madhe dhe Përlëshorja e së kremtes (1 herë).

Në Liturgji:

ANDIFONET e së kremtes.

HYRTORJA e së kremtes: *“Se pranë Teje është burimi i jetës, o Zot, me dritën tënde do të shohim dritë. Shpëtona, o i Biri i Perëndisë, që u shndërrove në Malin Thavor, ne që të psalim: Aliluia”.*

Pas HYRJES psalet Përlëshorja dhe Shkurtorja e së kremtes.

“SHENJT PERËNDI...”.

APOSTULLI i së kremtes (2 Pjet. 1:10-19).

UNGJILLI i së kremtes (Mtth. 17:1-9).

Te “VEÇAN TË TËRËSHENJTËN...”, psalet Madhështimi i së kremtes: “Të padëgjuarat u dëgjuan...”.

KUNGATORJA e së kremtes: “Me dritën e lavdisë...”.

Në vend të “PAMË DRITËN...”, psalet Përlëshorja e së kremtes.

Në shumë vende, sipas traditës, përpara ikonës së Shpëtimtarit Krisht vendosen bistakë rrushi të pjekur dhe pas uratës së Pasamvonës: “O Zot, që bekon ata që të bekojnë...”, psalet Përlëshorja. Më pas thuhet: “Lavdi...” dhe “Tani...”, Shkurtorja e së kremtes dhe prifti lexon uratën e Bekimit të rrushit: “Beko, o Zot, këtë fryt të ri të vreshtit...” (Uratoreja e Vogël: Urata për shijimin e rrushit më 6 gusht).

Më pas psalet: “Emri i Zotit...” dhe bëhet Përlëshimi si në Mbrëmësore.

Shënim: *Nga sot deri më 12 gusht, në Liturgji psalen Andifonet e së kremtes bashkë me refrenet e tyre. Si Hyrtore thuhet: “Ejani t’i falemi... Shpëtona... që u shndërrove në Malin Thavor...”. Shkurtorja e së kremtes.*

Të premtën në **mbrëmje**, kryhet MBRËMËSORJA e përditshme dhe PARAKLISI I VOGËL ose vetëm PARAKLISI I MADH (shih ndërthurjen e hollësishme në Tipikonë e datës 2 gusht, në mbrëmje).

7. † **E shtunë.** Oshënar dëshmor Domet Persiani dhe Asteri, mrekullibërës. Oshënar Nikanori, mrekullibërës.

Të shtunën në **mëngjes**, kryhet shërbesa e MËNGJESORES së përditshme.

Liturgjia Hyjnore

APOSTULLI i së shtunës së javës së 7-të të Letrave (Rom. 12:1-3).

UNGGJILLI paskremtues (Mk. 9:2-9).

Të shtunën në **mbrëmje**, **nuk kryhet** Shërbesa e PARAKLISIT, por Mbrëmësorja kremtuese e së dielës (shih më poshtë).

8. † **E DIEL. VII MATTHEUT** (Shërimi i dy të verbërve dhe i shurdhmemecit). Omologjet Emiliani i Kizikës. Mironi i Kretës. Dëshmori i ri Triandafili.

Tingulli Tërthor II. Ungjilli mëngjesor ngjallësor VII.

Në Mbrëmësore:

Shërbesa kryhet si zakonisht.

Pas “O ZOT, THIRRA...” psalen 6 Vargëzime ngjallësore dhe 4 Vargëzime të së kremtes. “Lavdi...”, e së kremtes. “Tani...”, Hyjlindësorja dogmatike Ting. Tërth. II: “Cili nuk do të të lumërojë...”.

HYRJA me temjanicë, “O Jisu Krisht, dritë gazmore...” dhe paravargu i ditës.

PASVARGJET ngjallësore. “Lavdi...” dhe “Tani...”, e së kremtes.

PËRLËSHORJA ngjallësore: “Fuqitë engjëllore...”. “Lavdi...” dhe “Tani...”, e së kremtes.

Në Mëngjesore:

Shërbesa kryhet si zakonisht.

Pas “PERËNDI ËSHTË ZOTI...”, Përlëshorja ngjallësore: “Fuqitë engjëllore...”. “Lavdi...”, po ajo: “Fuqitë engjëllore...”. “Tani...”, e së kremtes.

NDENJËSORET ngjallësore, por në vend të Hyjlindësoreve të çdo stikologjie (grupi), psalen Ndenjësoret e së kremtes.

BEKIMTORET ngjallësore. DËGJIMI, SHKALLESAT dhe PARAVARGU i tingullit.

SHKURTORJA dhe SHTËPIA ngjallësore. SINAKSARI i ditës.

ZBRITËSORET: “Një kryq vijosi me shkop...”.

“Le t’i lutemi Zotit...”, “Çdo frymë...” dhe UNGJILLI mëngjesor ngjallësor VII.

Pas Ungjillit lexohet: “Ne që pamë Ngjalljen...” dhe psalet PSALMI 50. Pas Psalmi 50 thuhet: “Lavdi...”, “Me ndërmjetimet e Apostujve...”. “Tani...”, “Me ndërmjetimet e Hyjlindësës...”. “Përdëllyes, përdëllemë...”,

“Kur u ngrit Jisui...”. Më pas thuhet: “O Perëndi, shpëtoje popullin tënd...”.

MADHËSHTIMET: pas thirrjes: “Hyjlindësen dhe Mëmën e Dritës...”, psalet: “Më të nderuarën...” dhe Zbritësorja IX: “O Hyjlindëse, parajsë mistike...”.

“I shenjtë është Zoti...” – “Lartësoni Zotin...”.

DËRGIMSORJA ngjallësore VII dhe e së kremtes.

LAVDËRIMET: psalen 4 Vargëzime ngjallësore dhe 3 Vargëzimet e së kremtes, të cilat bëhen 4.

“Lavdi...”, Lavdia mëngjesore ngjallësore VII. “Tani...”, “E përmbibekuar je...”.

DHOKSOLOGJIA e Madhe, “Sot erdhi shpëtimi...”.

Në Liturgji:

ANDIFONET e së kremtes bashkë me refrenet e tyre.

HYRTORJA: “Ejani t’i falemi... Shpëtona, o i Biri i Perëndisë, *që u ngjalle së vdekurish...*”

Pas HYRJES psalet Përlëshorja ngjallësore: “Fuqitë engjëllore...”, e së kremtes dhe e shenjtit të kishës. Shkurtorja e së kremtes.

APOSTULLI i së dielës së javës së 7-të të Letrave (Rom. 15:1-7).

UNGJILLI i së dielës së javës së 7-të të Mattheut (Mtth. 9:27-35).

Te “VEÇAN TË TËRËSHENJTËN...”, psalet: “Të meriton...”.

KUNGATORJA e së dielës: “Lavdëroni Zotin...”.

“PAMË DRITËN...”.

Të dielën në **mbrëmje**, kryhet MBRËMËSORJA e përditshme dhe PARAKLISI I MADH ose vetëm PARAKLISI I MADH (shih ndërthurjen e hollësishme në Tipikonë e datës 2 gusht, në mbrëmje).

9. E hënë. Apostull Matia. 10 dëshmorët në Portën e Bronztë. Dëshmore Patricia. Oshënar Psoi.

Të hënë në **mëngjes**, kryhet shërbesa e MËNGJESORES së përditshme.

APOSTULLI i shenjtit (kërkoje të Hënë e Javës së Ndrishtme – Vep. 1:12-17, 21-26).

UNGJILLI i së hënës së javës së 8-të të Mattheut (Mtth. 16:1-6).

Të hënë në **mbrëmje**, kryhet MBRËMËSORJA e përditshme PARAKLISI I VOGËL ose vetëm PARAKLISI I VOGËL (shih ndërthurjen e hollësishme në Tipikonë e datës 2 gusht, në mbrëmje).

10. E martë. Dëshmorët Laurenti, kryedhjakon, Ksisti i Romës, Ipoliti. Iron Filozofi.

Të martën në **mëngjes**, kryhet shërbesa e MËNGJESORES së përditshme.

APOSTULLI i së martës së javës së 8-të të Letrave (1 Kor. 10:5-12).

UNGJILLI i së martës së javës së 8-të të Mattheut (Mtth. 16:6-12).

Të martën në **mbrëmje**, kryhet shërbesa e MBRËMËSORES së përditshme dhe e PARAKLISIT TË MADH ose vetëm shërbesa e PARAKLISIT TË MADH (shih ndërthurjen e hollësishme në Tipikonë e datës 2 gusht, në mbrëmje).

11. E mërkurë. Patriark Nifoni, vëllami i Gjergj Kastriotit (Skënderbeut). Dëshmor Efpli, Gai, Gajani.

Të mërkurën në **mëngjes**, kryhet shërbesa e MËNGJESORES së përditshme.

APOSTULLI i së mërkurës së javës së 8-të të Letrave (1 Kor. 10:12-23).

UNJILLI i së mërkurës së javës së 8-të të Mattheut (Mtth. 16:20-24).

Të mërkurën në **mbrëmje**, kryhet shërbesa e MBRËMËSORES së përditshme dhe e PARAKLISIT TË VOGËL (shih ndërthurjen e hollësishme në Tipikonë e datës 2 gusht, në mbrëmje).

12. E enjte. Dëshmorët Foti, Anikiti. Dëshmorët Pamfili dhe Kapitoni. Oshënarët Palamoni dhe Kastori.

Të enjten në **mëngjes**, kryhet shërbesa e MËNGJESORES së përditshme.

APOSTULLI i së enjtes së javës së 8-të të Letrave (1 Kor. 10:28-11:8).

UNJILLI i së enjtes së javës së 8-të të Mattheut (Mtth. 16:24-28).

Të enjten në **mbrëmje**, kryhet shërbesa MBRËMËSORES kremtuese të mbylljes të së kremtes së Metamorfozës dhe e PARAKLISIT TË MADH.

MBRËMËSORJA e mbylljes të së kremtes kryhet njëloj si ditën e së kremtes (shih Tipikonë e datës 5 gusht), por pa thënë leximet biblike dhe troparet e Litisë. Pas “Tani përlëshoje...”, psalet shërbesa e PARAKLISIT TË MADH (sipas ndërthurjes së shpjeguar me hollësi në Tipikonë e datës 2 gusht, në mbrëmje).

13. E premtë. *Mbyllja e së kremtes së Metamorfozës.* Transferimi i lipsanit të Maksim Omologjetit (Pohuesit). Mbretëresha Evdhokia.

Shënim: *Shërbesën e së kremtes kërkoje më 6 gusht.*

Në Mëngjesore:

Shërbesa e Mëngjesores kremtuese kryhet njëllor si ditën e së kremtes (shih Tipikonë e Mëngjesores së datës 6 gusht), por me këto ndryshime:

Ndenjësorja e Polieleit (e grupit të tretë), nuk psalet.

Ungjilli dhe rendi i Ungjillit, nuk thuhet. Si rrjedhim, pas dy grupeve të para të Ndenjësove, lexohet menjëherë Psalmi 50. Dhe menjëherë pas Psalmi 50 thuhet Shkurtorja dhe Shtëpia e së kremtes dhe Sinaksari i ditës (d.m.th. i datës 13 gusht, jo ai i datës 6 gusht).

Pjesa tjetër e Mëngjesores - e njëjtë me të datës 6 gusht.

Në Liturgji:

Andifonet dhe Hyrtoja e së kremtes.

Pas Hyrjes, Përlëshorja dhe Shkurtorja e së kremtes.

APOSTULLI i së premtës së javës së 8-të të Letrave (1 Kor. 11:8-23).

UNGJILLI i së premtës së javës së 8-të të Mattheut (Mtth. 17:10-18).

Te “VEÇAN TË TËRËSHENJTËN...”, psalet irmosi i Këngës IX të kanonit të parë.

Kungatorja e së kremtes.

Në vend të: “Pamë dritën...”, psalet Përlëshorja e së kremtes.

Të premtën në **mbrëmje**, kryhet shërbesa MBRËMËSORES së përditshme dhe e PARAKLISIT TË

VOGËL ose vetëm shërbesa e PARAKLISIT TË VOGËL (shih ndërthurjen e hollësishme në Tipikonë e datës 2 gusht, në mbrëmje).

- 14. † E shtunë.** *Parakremtja e Fjetjes së Hyjlindëses.* Profeti Mikea. Kthimi i Kryqit të Nderuar. Hierodëshmor Markeli i Apamisë. Dëshmor Ursiki.

Të shtunën në **mëngjes**, kryhet shërbesa e MËNGJESORES së përditshme.

Liturgjia Hyjnore

APOSTULLI i së shtunës së javës së 8-të të Letrave (Rom. 13:1-10).

UNGJILLI i së shtunës së javës së 8-të të Mattheut (Mtth. 12:30-37).

- 15. † E DIEL. VIII. FJETJA E ZONJËS SONË SË TËRËSHENJTË, HYJLINDËSES DHE VIRGJËRE-SHËS MARI.** Dëshmor Tarsizi në Romë.

Tingulli i Rëndë. Ungjilli mëngjesor i së Kremtes.

Në Mbrëmësore:

Shërbesa kryhet si zakonisht.

Pas “O ZOT, THIRRA...” psalen 4 Vargëzime ngjallësore dhe 3 Vargëzimet e vetëmelodishme të së kremtes, të cilat bëhen 6 (thuhet të gjitha nga 2 herë). “Lavdi...” dhe “Tani...”, e së kremtes.

HYRJA me temjanicë, “O Jisu Krisht, dritë gazmore...”, Paravargu i ditës dhe leximet biblike (**Leximi I:** Gjen. 28:10-17; **Leximi II:** Ezek. 43:27-44:4; **Leximi III:** Fja. Urt. 9:1-11).

PASVARGJET ngjallësore. “Lavdi...” dhe “Tani...”, e së kremtes.

PËRLËSHORJA ngjallësore: “Dërrmove vdekjen me Kryqin tënd...”. “Lavdi...”, e së kremtes: “Në Lindjen tënde...”. “Tani...”, e së kremtes: “Në Lindjen tënde...”.

PËRLËSHIMI: “Ai që u ngjall prej së vdekurish, Krishti, Perëndia ynë i vërtetë, me ndërmjetimet e Nënës së tij të pacenuar, fjetjen e së cilës kremtojmë sot, me fuqinë e Kryqit...”.

Në Mëngjesore:

Shërbesa kryhet si zakonisht.

Pas “PERËNDI ËSHTË ZOTI...”, Përlëshoret psalen si në Mbrëmësore.

NDENJËSORET: Stikologjia (grupi) e parë: 2 Ndenjësore ngjallësore dhe 1 e së kremtes. Stikologjia (grupi) e dytë: 2 Ndenjësore ngjallësore dhe 1 e së kremtes. Stikologjia (grupi) e tretë: Ndenjësorja e së kremtes (2 herë).

BEKIMTORET ngjallësore nuk thuhën.

Menjëherë pas Ndenjësoreve, lexohet DËGJIMI i tingullit dhe psalen SHKALLESAT e tingullit. Pas Shkallesave thuhet PARAVARGU i së kremtes.

“Le t’i lutemi Zotit...”, “Çdo frymë...” dhe UNGJILLI mëngjesor i së kremtes (Llk. 1:39-49, 56), i cili lexohet te Dera e Bukur.

Pas Ungjillit lexohet: “Ne që pamë Ngjalljen...” dhe PSALMI 50. Dhe më pas thuhet: “Lavdi...”, “Me ndërmjetimet e Hyjlindëses...”. “Tani...”, “Me ndërmjetimet e Hyjlindëses...”. “Përdëllyes, përdëllemë...”, tropari i vetëmelodishëm i së kremtes. Më pas thuhet: “O Perëndi, shpëtoje popullin tënd...”.

SHKURTORJA dhe SHTËPIA e së kremtes.
SINAKSARI i ditës.

ZBRITËSORET e së kremtes: “I lavdëruar dhe i gëzuar...”.

MADHËSHTIMET: Pas Këngës VIII thuhet thirrja: “Hyjlindësen dhe Mëmën e Dritës...” dhe, në vend të: “Më të nderuarën...”, psalet Kënga IX e të dy kanoneve dhe në fund thuhet Zbritësorja IX.

“I shenjtë është Zoti...” – “Lartësoni Zotin...”.

DËRGIMSORJA ngjallësore VIII dhe e së kremtes (2 herë).

LAVDËRIMET: psalen 4 Vargëzime ngjallësore dhe 3 Vargëzimet e përshembullta të së kremtes, të cilat bëhen 4 (e para thuhet dy herë). “Lavdi...”, e së kremtes. “Tani...”, “E përmbibekuar je...”.

DHOKSOLOGJIA e Madhe, “Sot erdhi shpëtimi...”.

Në Liturgji:

ANDIFONET e së kremtes, por tek Andifoni II thuhet: “Shpëtona, o i Biri i Perëndisë, *që u ngjalle së vdekurish*, ne që...”.

HYRTORJA: “Ejani t’i falemi... Shpëtona, o i Biri i Perëndisë, *që u ngjalle së vdekurish...*”

Pas HYRJES psalet Përlëshorja ngjallësore: “Dërrmove vdekjen...”, e së kremtes: “Në lindjen tënde...” dhe Shkurtorja e së kremtes.

APOSTULLI i së kremtes (Filip. 2:5-11).

UNGJILLI i së kremtes (Llk. 10:38-42, 11:27-28).

Te “VEÇAN TË TËRËSHENJTËN...”, psalet Madhështimi i së kremtes.

KUNGATORJA e së kremtes.

“PAMË DRITËN...” dhe pjesa e mbetur e Liturgjisë.

Shënim: Nga nesër deri më 23 gusht, si zbritësore thuhet irmoset e kanonit të së kremtes: “I lavdëruar dhe i gëzuar...”. Në Liturgji psalen Andifonet dhe Shkurtorja e së kremtes.

- 16. E hënë.** Transferimi i peshqirit të Zotit Krisht (i ikonës që nuk është bërë nga dora e njeriut, domethënë i ikonës së Shamisë së shenjtë). Dëshmorët Alkiviadhi, Diomidi. Oshënar Gjerasimi në Kefaloni.

Mbrëmësorja e përditshme.

Mëngjesorja e përditshme.

APOSTULLI i datës 16 gusht (kërkoje të shtunën para Theofanisë – 1 Tim. 3:13-4:5).

UNGJILLI i Shamisë së Shenjtë (kërkoje më 16 gusht – Llk. 9:51-57, 10:22-24 dhe 13:22).

- 17. E martë.** Dëshmor Mironi, Patrokli, Straton, Filipi. Dëshmorët Pavli dhe Juliana. Oshënar Egloni.

Mbrëmësorja e përditshme.

Mëngjesorja e përditshme.

APOSTULLI i së martës së javës së 9-të të Letrave (1 Kor. 12:12-26).

UNGJILLI i së martës së javës së 9-të të Mattheut (Mtth. 18:18-22, 19:1-2, 13-15).

- 18. E mërkurë.** Dëshmorë Flori dhe Lauri në Dardani. Arseni në Paros. Dëshmor Polieni.

Mbrëmësorja e përditshme.

Mëngjesorja e përditshme.

APOSTULLI i së mërkurës së javës së 9-të të Letrave (1 Kor. 13:4-14:5).

UNGJILLI i së mërkurës së javës së 9-të të Mattheut (Mtth. 20:1-16).

19. E enjte. Dëshmor Andrea Stratilati dhe 2.593 dëshmorët me të. Oshënar Theofani i Ri, mrekullibërës.

Mbrëmësorja e përditshme.

Mëngjesorja e përditshme.

APOSTULLI i së enjtes së javës së 9-të të Letrave (1 Kor. 14:6-19).

UNGJILLI i së enjtes së javës së 9-të të Mattheut (Mtth. 20:17-28).

20. E premte. Profeti Samuel. 37 dëshmorët në Vizi (Orioni etj.). Dëshmor Iliodori. Dëshmor i ri Theohari.

Mbrëmësorja e përditshme.

Mëngjesorja e përditshme.

APOSTULLI i së premtes së javës së 9-të të Letrave (1 Kor. 14:26-40).

UNGJILLI i së premtes së javës së 9-të të Mattheut (Mtth. 21:12-14, 17-20).

21. † E shtunë. Apostull Tadeu. Dëshmore Vasa me bijtë: Theogni, Agapi dhe Pisti.

Mbrëmësorja e përditshme.

Mëngjesorja e përditshme.

Liturgjia Hyjnore

APOSTULLI i së shtunës së javës së 9-të të Letrave (Rom. 14:6-9).

UNGJILLI i së shtunës së javës së 9-të të Mattheut (Mtth. 15:32-39).

22. † E DIEL. IX MATTHEUT (Jisui ecën mbi ujë).

Dëshmor Agathoniku etj. Mbretëresha Ariadhni.
Dëshmore Jona, Evlalia.

Tingulli Tërthor IV. Ungjilli mëngjesor ngjallësor IX

Në Mbrëmësore:

Shërbesa kryhet si zakonisht.

Pas “O ZOT, THIRRA...” psalen 6 Vargëzime ngjallësore dhe 3 Vargëzimet e së kremtes, të cilat bëhen 4. “Lavdi...”, e së kremtes. “Tani...”, Hyjlindësorja dogmatike e Ting. Tërth. IV: “Mbreti i qiejve...”.

HYRJA me temjanicë, “O Jisu Krisht, dritë gazmore...” dhe paravargu i ditës.

PASVARGJET ngjallësore. “Lavdi...” dhe “Tani...”, e së kremtes.

PËRLËSHORJA ngjallësore: “Që lartazi zbritë...”. “Lavdi...” dhe “Tani...”, e së kremtes: “Në lindjen tënde...”.

Në Mëngjesore:

Shërbesa kryhet si zakonisht.

Pas “PËRËNDI ËSHTË ZOTI...”, psalet Përlëshorja ngjallësore: “Që lartazi zbritë...”. “Lavdi...”, po ajo: “Që lartazi...”. “Tani...”, e së kremtes: “Në lindjen tënde...”.

NDENJËSORET ngjallësore, por në vend të Hyjlindësoreve të çdo stikologjie (grupi), psalen Ndenjësoret e së kremtes.

BEKIMTORET ngjallësore. DËGJIMI, SHKALLESAT dhe PARAVARGU i tingullit.

SHKURTORJA dhe SHTËPIA ngjallësore. SINAKSARI i ditës.

ZBRITËSORET: “I lavdëruar dhe i gëzuar...”.

“Le t’i lutemi Zotit...”, “Çdo frymë...” dhe UNGJILLI mëngjesor ngjallësor IX.

Pas Ungjillit lexohet: “Ne që pamë Ngjalljen...” dhe psalet PSALMI 50. Pas Psalmit 50 thuhet: “Lavdi...”, “Me ndërmtjetimet e Apostujve...”. “Tani...”, “Me ndërmtjetimet e Hyjlindëses...”. “Përdëllyes, përdëllemë...”, “Kur u ngrit Jisui...”. Më pas thuhet: “O Perëndi, shpëtoje popullin tënd...”.

MADHËSHTIMET: pas thirrjes: “Hyjlindësen dhe Mëmën e Dritës...”, psalet: “Më të nderuarën...” dhe në fund Zbritësorja IX.

“I shenjtë është Zoti...” – “Lartësoni Zotin...”.

DËRGIMSORJA ngjallësore IX dhe e së kremtes (1 herë).

LAVDËRIMET: psalen 4 Vargëzime ngjallësore dhe 3 Vargëzimet e së kremtes, të cilat bëhen 4.

“Lavdi...”, lavdia mëngjesore ngjallësore IX. “Tani...”, “E përmbibekuar je...”.

DHOKSOLOGJIA e Madhe, “Sot erdhi shpëtimi...”.

Në Liturgji:

ANDIFONET e së kremtes, por te refreni i dytë thuhet: “Shpëtona... që u ngjalle së vdekurish...”.

HYRTORJA: “Ejani t’i falemi... Shpëtona, o i Biri i Perëndisë, që u ngjalle së vdekurish, ne që të psalim: Aliluia”.

Pas HYRJES psalet Përlëshorja ngjallësore: “Që lartazi...”, e së kremtes: “Në lindjen tënde...” dhe e shenjtit të kishës. Shkurtorja e së kremtes.

APOSTULLI i së dielës së 9-të të Letrave (1 Kor. 3:9-17).

UNJILLI i së dielës së 9-të të Mattheut (Mtth. 14:22-34).

Te “VEÇAN TË TËRËSHENJTËN...”, psalet: “Të meriton...”.

KUNGATORJA e së dielës: “Lavdëroni Zotin...”.

“PAMË DRITËN...” dhe pjesa e mbetur e Liturgjisë.

23. E hënë. *Mbyllja e së kremtes së Fjetjes së Hyjlindëses.*

Hierodëshmor Irineu i Lionit. Hierodëshmor Irineu i Sirmiumit. Dëshmor Lupi.

Në Mbrëmësore:

Shërbesa kryhet si zakonisht.

Pas “O ZOT, THIRRA...” psalen 3 Vargëzimet e përshembullta të së kremtes, të cilat bëhen 6 (thuhet të tria nga 2 herë). “Lavdi...” dhe “Tani...”, e së kremtes.

HYRJA. “O Jisu Krisht, dritë gazmore...” dhe paravargu i ditës

PASVARGJET e së kremtes. “Lavdi...” dhe “Tani...”, e së kremtes.

PËRLËSHORJA e së kremtes (3 herë).

PËRLËSHIMI: “Krishti, Perëndia ynë i vërtetë, me ndërmjetimet e Nënës së tij të pacenuar, fjetjen e së cilës kremtojmë sot, me fuqinë e Kryqit...”.

Në Mëngjesore:

Shërbesa kryhet si zakonisht.

Pas “PERËNDI ËSHTË ZOTI...”, psalet Përlëshorja e së kremtes (3 herë).

NDENJËSORET e së kremtes (vetëm stikologjia (grupi) e parë dhe e dytë).

Menjëherë pas Ndenjësove lexohet PSALMI 50. Dhe menjëherë pas Psalmit 50 lexohet:

SHKURTORJA dhe SHTËPIA e së kremtes. SINAKSARI i ditës (i datës 23 gusht).

ZBRITËSORET: “I lavdëruar dhe i gëzuar...”.

MADHËSHTIMET: Pas Këngës VIII thuhet thirrja: “Hyjlindësen dhe Mëmën e Dritës...” dhe, në vend të: “Më të nderuarën...”, psalet Kënga IX e të dy kanoneve dhe në fund thuhet Zbritësorja IX.

DËRGIMSORJA e së kremtes (3 herë).

LAVDËRIMET: psalen 3 Vargëzimet e përshembullta të së kremtes, të cilat bëhen 4 (e para thuhet 2 herë). “Lavdi...” dhe “Tani...”, e së kremtes.

DHOKSOLOGJIA e Madhe, Përlëshorja e së kremtes .

Nëse do të kryhet Liturgji:

ANDIFONET e së kremtes.

HYRTORJA: “Ejani t’i falemi... Shpëtona, o i Biri i Perëndisë, o i çuditshëm ndër shenjtorët, ne që të psalim: Aliluia”.

Pas HYRJES psalet Përlëshorja dhe Shkurtorja e së kremtes.

APOSTULLI i së kremtes (Filip. 2:5-11).

UNGJILLI i së kremtes (Llk. 10:38-42, 11:27-28).

Te “VEÇAN TË TËRËSHENJTËN...”, psalet Madhështimi i së kremtes.

KUNGATORJA e së kremtes: “Kupë shpëtimi...”.

“PAMË DRITËN...” dhe pjesa e mbetur e Liturgjisë.

Shënim: Nga nesër deri më 21 shtator, në Mëngjesore psalen Zbritësoret: “Një Kryq vijosi me shkop...”. Nga nesër deri më 12 shtator, në Liturgji psalet Shkurtorja e lindjes së Hyjlindëses: “Joakimi dhe Ana...” (përveç datës 31 gusht, 1 dhe 7 shtator).

24. † E martë. Hierodëshmor Kozma Etolosi, martirizuar në Kolkondas (Fier). Hierodëshmor Eftihi.

Në Mbrëmësore:

Shërbesa kryhet si zakonisht.

Pas “O ZOT, THIRRA...” psalen 3 Vargëzimet e përshebullta të shenjtit, të cilat bëhen 6 (thuhen të gjitha nga 2 herë). “Lavdi...”, e shenjtit. “Tani...”, Hyjlindësorja dogmatike në të njëjtin tingull me Lavdinë e shenjtit: “Cili nuk do të të lumërojë...”.

HYRJA, “O Jisu Krisht, dritë gazmore...”, PARAVARGU i ditës dhe LEXIMET biblike (**Leximi I:** Fja. Urt. 10:6-7; 3:13-16, 8:6, 34-35, 4, 12, 14, 17, 5-9; 22: 21, 19; 15:4; **Leximi II:** Isa. 43:9-14; **Leximi III:** Urt. Sol. 3:1-9).

PASVARGJET e shenjtit. “Lavdi...”, e shenjtit. “Tani...”, Hyjlindësorja në të njëjtin tingull me Lavdinë e Pasvargjeve të shenjtit.

PËRLËSHORJA e shenjtit. “Lavdi...” dhe “Tani...”, Hyjlindësorja në të njëjtin tingull me Lavdinë.

Në Mëngjesore:

Shërbesa kryhet si zakonisht.

Pas “PËRËNDI ËSHTË ZOTI...”, psalet Përlëshorja e shenjtit. “Lavdi...”, po ajo. “Tani...”, Hyjlindësorja në të njëjtin tingull me Lavdinë e shenjtit.

NDENJËSORET e shenjtit.

SHKALLESAT: “Që prej rinisë sime...” dhe paravargu i shenjtit.

“Le t’i lutemi Zotit...”, “Çdo frymë...” dhe UNGJILLI mëngjesor i shenjtit (kërkoje të mërkurën e javës së 3-të të Mattheut – Mthh. 10:16-22).

Pas Ungjillit lexohet PSALMI 50. Pas Psalmi 50 thuhet: “Lavdi...”, “Me ndërmjetimet e Hierodëshmorit...”. “Tani...”, “Me ndërmjetimet e Hyjlindëses...”. “Përdëllyes, përdëllemë...”, tropari i shenjtitorit. Më pas thuhet: “O Perëndi, shpëtoje popullin tënd...”.

SHKURTORJA dhe SHTËPIA e shenjtit. SINAKSARI i ditës.

ZBRITËSORET: “Një Kryq vijosi me shkop...”.

MADHËSHTIMET: pas thirrjes: “Hyjlindësen dhe Mëmën e Dritës...”, psalet: “Më të nderuarën...” dhe Zbritësorja IX.

DËRGIMSORET e shenjtit.

LAVDËRIMET: psalen 3 Vargëzimet e përshembullta të shenjtit, të cilat bëhen 4. “Lavdi...”, e shenjtit. “Tani...”, Hyjlindësorja në të njëjtin tingull me Lavdinë e shenjtit.

DHOKSOLOGJIA e Madhe dhe Përlëshorja e shenjtit.

Në Liturgji:

ANDIFONET e të kremteve të dëshmorëve.

Pas HYRJES psalet Përlëshorja e shenjtit dhe e shenjtit të kishës. Shkurtorja e lindjes së Hyjlindëses: “Joakimi dhe Ana...” (8 shtator).

APOSTULLI i së martës së javës së 10-të të Letrave (1 Kor. 15:29-38).

UNGJILLI i së martës së javës së 10-të të Mattheut (Mthh. 21:23-27).

Te “VEÇAN TË TËRËSHENJTËN...”, psalet: “Të meriton...”.

KUNGATORJA: “Në tërë dheun...”.

“PAMË DRITËN...” dhe pjesa e mbetur e Liturgjisë.

25. E mërkurë. Apostull Titi i Gortinës, nga të 70-t. Transferimi i lisanit të Apostull Vartholomeut.

Mbrëmësorja e përditshme.

Mëngjesorja e përditshme.

APOSTULLI i apostull Titit (kërkoje më 25 gusht - Tit. 1:1-5, 2:15-3:2, 12-15).

UNGJILLI i apostujve (kërkoje më 12 nëntor - Mth. 5:14-19).

26. E enjte. Dëshmorët Adriani dhe Natalia. Dëshmorët Atiku dhe Sisini. Oshënar Joasafi, princ në Indi.

Mbrëmësorja e përditshme.

Mëngjesorja e përditshme.

APOSTULLI i së enjtes së javës së 10-të të Letrave (2 Kor. 1:1-7).

UNGJILLI i së enjtes së javës së 10-të të Mattheut (Mth. 21:43-46).

27. E premte. Oshënar Pimeni. Dëshmor Fanuri. Dëshmore Anthusa e Re. Omologjet Osios i Kordovës.

Mbrëmësorja e përditshme.

Mëngjesorja e përditshme.

APOSTULLI i së premtes së javës së 10-të të Letrave (2 Kor. 1:12-20).

UNGJILLI i së premtes së javës së 10-të të Mattheut (Mtth. 22:23-33).

28. † E SHTUNË. Ezekia i Drejtë, mbret. Oshënar Moisi Etiopiani. Dëshmorët Diomidi dhe Laurenti.

Mbrëmësorja e përditshme.

Mëngjesorja e përditshme.

Liturgjia Hyjnore

APOSTULLI i së shtunës së javës së 10-të të Letrave (Rom. 15:30-33).

UNGJILLI i së shtunës së javës së 10-të të Mattheut (Mtth. 17:24-18:4).

29. † E DIEL. PRERJA E KOKËS SË JOAN PAGËZORIT.

Arkadi i Arsinoit.

Tingulli I. Ungjilli mëngjesor ngjallësor X.

Kreshmë, hahet vaj dhe verë.

Në Mbrëmësore:

Shërbesa kryhet si zakonisht.

Pas “O ZOT, THIRRA...” psalen 7 Vargëzimet ngjallësore, që bëhen 8. “Lavdi...” dhe “Tani...”, Hyjlindësorja dogmatike e Ting. I: “Lavdinë e përbotshme...”.

HYRJA, “O Jisu Krisht, dritë gazmore...” dhe PARAVARGU i ditës.

PASVARGJET ngjallësore, “Lavdi...” dhe “Tani...”, Hyjlindësorja e Pasvargjeve: “Ja ku u përmbush profecia...”.

PËRLËSHORJA ngjallësore: “Guri kur u vulos...”.
 “Lavdi...”, e Pararendësit: “I drejti kujtohet përjetë...”.
 “Tani...”, Hyjlindësorja: “Të gjitha përmbi mendim...”.

Në Mëngjesore:

Shërbesa kryhet si zakonisht.

Pas “**PERËNDI ËSHTË ZOTI...**”, Përlëshoret psalen si në Mbrëmësore.

NDENJËSORET ngjallësore, sipas radhës, por në vend të Hyjlindësorese së stikologjisë (grupit) së parë thuhet Hyjlindësorja e Përlëshoreve: “Gabrieli kur të tha...”.

BEKIMTORET ngjallësore, **SHKALLESAT**, **DËGJIMI DHE PARAVARGU** i tingullit.

SHKURTORJA dhe **SHTËPIA** e tingullit. **SINAKSARI** i ditës.

ZBRITËSORET: “Një Kryq vijosi me shkop...”.

“Le t’i lutemi Zotit...”, “Çdo frymë...” dhe **UNGJILLI** mëngjesor ngjallësor X.

Pas Ungjillit lexohet: “Ne që pamë Ngjalljen...” dhe psalet **PSALMI 50**. Pas Psalmi 50 thuhet: “Lavdi...”, “Me ndërmjetimet e Apostujve...” etj. Më pas thuhet: “O Perëndi, shpëtoje popullin tënd...”.

MADHËSHTIMET: pas thirrjes: “Hyjlindësen dhe Mëmën e Dritës...”, psalet: “Më të nderuarën...” dhe Zbritësorja IX.

“I shenjtë është Zoti...” – “Lartësoni Zotin...”.

DËRGIMSORJA ngjallësore X dhe Hyjlindësorja e saj.

LAVDËRIMET: psalen 8 Vargëzimet ngjallësore. “Lavdi...”, Lavdia mëngjesore ngjallësore X. “Tani...”, “E përmbibekuar je...”.

DHOKSOLOGJIA e Madhe dhe “Sot erdhi shpëtimi...”.

Në Liturgji:

ANDIFONET e së dielës.

Pas HYRJES psalet Përlëshorja ngjallësore: “Guri kur u vulos...”, e Pararendësit: “I drejti kujtohet kudo me këngë...” dhe e shenjtit të kishës. Shkurtorja: “Joakimi dhe Ana...”.

APOSTULLI i Pararendësit (Vep. 13:25-32).

UNGJILLI i Pararendësit (Mk. 6:14-30).

Te “VEÇAN TË TËRËSHENJTËN...”, psalet: “Të meriton...”.

KUNGATORJA e së dielës: “Lavdëroni Zotin...”.

“PAMË DRITËN...” dhe pjesa e mbetur e Liturgjisë.

30. E hënë. Aleksandri, Pavli dhe Joani, të Konstandinopojës. Oshënar Fantini. Oshënore Vriena.

Mbrëmësorja e përditshme.

Mëngjesorja e përditshme.

APOSTULLI i së hënës së javës së 11-të të Letrave (2 Kor. 2:3-15).

UNGJILLI i së hënës së javës së 11-të të Mattheut (Mtth. 23:13-22).

31. E martë. Vendosija e brezit të nderuar të Hyjlindëses së Tërëshenjtë në kishën e Konstandinopojës. Aidani i Lindisfernit. Dëshmor Fileorti.

Mbrëmësorja e përditshme.

Mëngjesorja e përditshme.

APOSTULLI i Hyjlindëses (21 nëntor - Heb. 9:1-7).

UNGJILLI i Hyjlindëses (8 shtator - Llk. 10:38-42, 11:27-28).